



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë

Tiranë, më 27. 1. 2020

Dokument parlamentar

R A P O R T

Hyrje:

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, shqyrtoi në datën 27.1.2020 mbledhjen e komisionit për projektligjin “Për pranimin e instrumentit të amendamentit të kushtetutës së organizatës ndërkombëtare të punës, 1986”.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

1. Baza kushtetuese e projektligjit.

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin bazuar në nenet 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

2. Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.

Projektligji synon pranimin e amendamentit Kushtetues të ILO-s, për t’iu bashkuar 108 vendeve të cilat e kanë ratifikuar atë tashmë. Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e thirrur në Gjenevë nga organi qeverisës i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe mbledhur në sesionin e saj të 72, më 4 qershor 1986, ka vendosur miratimin e disa ndryshimeve të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, që citohet si instrumenti i amendamentit të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986.

Ndryshimet në Kushtetutën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës kanë të bëjnë me qëllimet themelore të Organizatës, selinë e përhershme të Organizatës, përbërjen dhe funksionet e organeve të saj kolegjiale, emërimin dhe përgjegjësitë e drejtorit të

Përgjithshëm, dispozitat kushtetuese në lidhje me konventat dhe rekomandimet ndërkombëtare të punës.

Një shtet anëtar pranon këto ndryshime nëpërmjet dy instrumenteve, pranim ose ratifikim. Këto ndryshime referuar dhe nenit 36 të kësaj Kushtetute që do të hyjë në fuqi nëse ratifikohen apo pranohen nga $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të Organizatës.

Që ky amendament të hyjë në fuqi duhet të ratifikohet ose të pranohet nga 125 vende nga 187 që janë anëtare të saj.

Deri më tani (datë 24 qershor 2019) janë 110 vende të cilat e kanë pranuar apo ratifikuar këtë ndryshim. Kërkohen edhe 15 ratifikime apo pranime nga vendet përkatëse që ky ndryshim të hyjë në fuqi.

Ndryshimet në Kushtetutën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës kanë të bëjnë me qëllimet themelore të Organizatës, selinë e përhershme të Organizatës, përbërjen dhe funksionet e organeve të saj kolegjiale, emërimin dhe përgjegjësitë e drejtorit të Përgjithshëm, dispozitat kushtetuese në lidhje me konventat dhe rekomandimet ndërkombëtare të punës.

Sipas amendamentit të vitit 1986, numri i anëtarëve të trupit udhëheqës sipas Kushtetutës do të rritet nga 56 në 112, nga të cilët, 56 do t'u jepen përfaqësuesve qeveritarë dhe nga 28 secili përfaqësuesve të punëdhënësve dhe punëtorëve. Ndërkohë, nuk do të ketë më vende të garantuara për shtetet anëtare me rëndësi të madhe industriale.

2. Procedura e caktimit të drejtorit të Përgjithshëm.

Sipas amendamentit të vitit 1986, drejtori i Përgjithshëm do të vijojë të caktohet nga trupi drejtues (GB) por do të aprovohet në Konferencën Ndërkombëtare të Punës.

3. Efektet financiare.

Ky projektvendim nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

4. Diskutimi në Komision.

Komisioni theksoi se projektligji është me rëndësi të veçantë, pasi ky projektligj synon pranimin e amendamentit Kushtetues të ILO-s, për t'iu bashkuar 108 vendeve të cilat e kanë ratifikuar atë dhe perzgjedh përbërjen dhe drejtimin i trupit drejtues (GB) të zyrës, Si dhe rregullat e procedurës për amendimin e Kushtetutës.

5. Përfundim.

Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

KRYETAR

Enver Roshi